Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 210/19
Datë/Datum. 17.05.2019.
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit AK: **Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës** OE ankues: **"Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. - Prishtinë**	Kopje	Paneli Shqyrtues – OSHP: **Nr. 210/19**
Prej:	**Sahit Beqiri** – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me **Nr. 210/19** të parashtruar nga OE: **"Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. - Prishtinë**		
Datë	17.05.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën me datën: **13.05.2019** me **Nr. 210/19** të parashtruar nga OE: **"Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. - Prishtinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Avancimi i sistemit të zërimit të ASHAK-ut",** me nr. prokurimi: **213-19-2534-1-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – "Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. - Prishtinë*

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY
RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

Begimmmm	**15.05.2019**	**15.05.2019**	**17.05.2019**
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të ekspertit	Data e fillimit të ekspertizës	Data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **13.05.2019** OE: **"Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. - Prishtinë,** ka parashtruar ankesë në OSHP, **kundër njoftimit për kontratë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Avancimi i sistemit të zërimit të ASHAK-ut",** me nr. prokurimi: **213-19-2534-1-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.**
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

N.111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues: *"Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. - Prishtinë*

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues: "Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. - Prishtinë, janë:

- **Neni 7 – Barazia ne trajtim/Jo Diskriminim (paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7)**
- **Neni 28 Specifikimet teknike (paragrafi 2, 7, 9)**
- **Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Duke ju referuar dosjes se tenderit, Seksioni II. Fleta e te dhënave te Tenderit, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2, nen 6) është kërkuar **"Te gjitha pajisjet e ofruara duhet te jene te prodhuesit (brendit) te njëjtë dhe te prodhuar ne Evropë",** ndërsa ne Dëshmia e kërkuar Dokumentare është kërkuar nen 6) **"Te ofrohet certifikata CE për pajisjet – kopje (me mundësi verifikimi)".** Kjo nuk korrespondon me kërkesë pasi qe kërkohet qe produktet te jene te prodhuara ne Evropë, ndërsa si dëshmi për ta dokumentuar atë kërkohet certifikata e konformitetit evropian CE (Conformite Europeenne) qe nënkupton se produkti/et janë te prodhuara konform standardeve mbrojtëse te ambigjenit, sigurisë dhe shëndetit me te drejt shitjeje brenda zonës ekonomike evropiane EEA (Europian Economic Area) dhe një certifikatë e tille nuk dëshmon origjinën e produktit. Megjithatë, ne me date 03.05.2019 kemi bere kërkesë për sqarime shtese duke dërguar Aneksi 5 Kërkesa për Informacione Shtese, ku kemi kërkuar sqarime nëse pranohen produktet e prodhuara jashtë kontinentit te Evropës, AK me date 06.05.2019 është përgjigjur negativisht duke thënë **"Te gjitha pajisjet duhet te jene te brendit te njëjtë dhe te prodhuara ne Evropë sipas standardeve evropiane. Kjo nënkupton se nuk mund te ofertohen pajisjet e prodhuara jashtë Evrope"** (shih përgjigjen e bashkangjitur).
Te gjitha produktet qe prodhohen ne këtë fushe qofshin ato evropiane apo edhe nga kontinentet tjera bazohen kon formë standardeve qe u tha me lartë. Pra, te gjithë prodhuesit qe kanë synim tregun evropian edhe pse mund te mos jene te prodhuara ne Evrope. Certifikata CE tregon se prodhuesi/t pohon se produkti është ne pajtim/pëlqim me legjislacionin relevant te aplikueshëm ne EU, pra pavarësisht vendit te prodhimit/origjinës. Për me shume informata rreth CE mark apo certifikimit klikoni ne: https://en.wikipedia.org/wiki/CE_marking apo mund te gjeni ne ubsajtin zyrtar te EU.

S.B

Duke ju referuar udhëzimeve ne "Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Elektronik" , edicioni i fundit i lansuar me date 10.04.2019, thuhet qartë se AK nuk ka te drejt te përpilojë specifikim teknik te ndonjë produkti qe ka origjine ose nga ndonjë rajon i veçantë gjeografik. Këtë mund ta gjeni nen 20. Specifikimet Teknike, "**20.8 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar.** Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdorët në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët **"ose e barasvlershme/ekuivalente".**

Nen neni 7 Barazia ne trajtim/Jo-diskriminim te LPP-se, paragrafi 4 thuhet, *"Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik."*

dhe nen paragrafin 5 *"Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të*

(i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose

(ii) *që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik.*

Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit".

Neni 28 Specifikimet teknik, qartazi thuhet se AK ka te drejt te formuloj specifikimi teknik duke iu referuar ndonjë standardi Vendor, Evropian ose Ndërkombëtar **(paragrafi 4 dhe 5),** mirëpo nuk ka te drejt te kërkoj produkte qe kane origjine te veçantë. Këtë mund ta gjeni ne paragrafin 4 *"Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar*

(i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian,

(ii) një standardi Evropian.

(iii) një miratimi teknik Evropian,

(iv) një specifikimi të përbashkët teknik,

(v) një standardi ndërkombëtar apo

(vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.

dhe paragrafi 5 *"Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar*

(i) një standardi të Kosovës ose

(ii) një miratimi teknik të Kosovës.

Ndërsa nën paragrafi 7 nuk lejohet qe AK te përpiloj specifikim teknik qe i referohet një origjine te veçantë *"Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"*

Në përgjigjen e AK-së me date 07.05.2019, përsëri krijon paqartësi dhe duke mos marr për baze dispozitat ligjore te LPP-se vendos te vazhdoj me kritere diskriminuese dhe antiligjore, duke paragjykuar sipas përgjigjes nr. ***3 Kërkesa e njësisë kërkuese te autoriteti kontraktues ka te bëjë me produkte cilësore dhe operator ekonomik profesional dhe me pamundësinë e depërtimit te produkteve jo cilësore dhe te operatoreve ekonomik profesional",*** AK ka bërë paragjykim ne produkte qe kane origjine ne kontinentet tjera duke diskriminuar prodhuesit e produkteve kualitative dhe operatoreve ekonomik. Mendojmë qe për te pamundësuar depërtimin e operatoreve ekonomik, AK është dashtë te kërkoj listën e kontratave te implementuara te natyrës se njëjtë përgjatë 3 viteve te shkuara me kopje te referencave

S.B

pozitive qe dëshmojnë se OE ka përvojë ne këtë fushe dhe ka bere implemtntimin e projektit/eve ne kohe dhe kualitet, gjë qe AK nuk e ka vendos një kriter te tille. Me këtë raste, AK mundohet qe përmes kriterit te kundërligjshëm te origjinës se produktit te diskriminoje operatoret tjerë ekonomik qe janë profesional ne këtë fushe,
Si përfundim, kërkojmë qe te behet rishqyrtimi i kritereve te mundësohet ofertomi i produkteve kualitative e qe kane origjine jashtë kontinentit te Evropës e qe plotësojnë specifikat teknike te kërkuara, te ceket ne specifikim teknik **"të barasvlershme/ekuivalente"** ashtu siç e kërkon LPP-së.

Mendojmë se kriteret e vendosura ne dosje te tenderit janë tendencioze dhe përbejnë shkelje te Ligjit te Prokurimit Publik, përkatësisht te nenit 7, 28 dhe 69 dhe ju lusim juve si Organ Shqyrtues te Prokurimit, te bëni vlerësimin e këtyre fakteve dhe te konstatoni shkeljet e lartpërmendura dhe te urdhëroni AK te veproj ne kuadër te dispozitave ligjore te parapara me LPP.

Pretendimet ankimore tek dispozitat e shkelura nga AK ligjore janë të njëjta me kërkesën për rishqyrtim pran AK – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: 26.04.20819

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Kontratë kornizë ka kohëzgjatje prej **6** muajsh, Furnizim

Vlera e parashikuar e kontratës:..... 62,000.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës (N.52)..... Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave..... 17.05.2019

Data e hapjes së ofertave..... ..... 17.05.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave..... Ankesa është **para hapjes se tenderit**

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm ..... N/A

Data e njoftimit mbi Vendimin e AK - B58 ..... N/A

Data e kërkesës për rishqyrtim..... 07.05.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim..... 07.05.2019

5.B

Kriteret për vlerësim:

III.2 KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat: 1. Deklarata nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri sikurse është cekur në nenin 65 të Ligjit LPP-Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, indryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237,ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092	**Evidencat:** Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë: 1.Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit ASHAK ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të ASHAK, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe ASHAK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në ranglistë. Dokumentet te cilat do te kërkohen si dështmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon a. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) b.Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje).

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Përshtatshmëria profesionale:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat: 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit 2. Certifikatë e numrit fiskal. 3. Certifikatë e TVSh-së.	**Evidencat:** 1.Të dëshmohet me Certifikatë të Regjistrimit tv Biznesit si dhe me informacione të biznesit-Kopje 2.Të dëshmohet me Certifikatë të numrit Fiskal- Kopje 3.Të dëshmohet me certifikatë të TVSh-së – Kopje

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat: 1.Qarkullimi financiar nga një bankë e licencuar në vlerë prej 124,000.00€, për 3 vjetët e fundit (2016, 2017, 2018).	**Evidencat:** 1.Raportin përmbledhës për 3 vjetët e fundit (2016, 2017, 2018).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesat: 1. Autorizim në origjinal nga	**Evidencat:** 1. Autorizimi nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi (me të dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, web faqja

5-B

prodhuesi. **2.Deklaratë për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara dhe katalogu i prodhuesit.** **3.Afati i realizimit 60 ditë.** **4.Garancioni për pajisje.** **5. Trajnimi i stafit.** **6.Të gjitha pajisjet e ofruara duhet të jenë të prodhuesit (brendit) të njëjtë dhe të prodhuara në Evropë.**	**etj, për mundësi të verifikimit)- origjanal. Në rast të autorizimit nga përfaqësuesi-dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.** **2. Broshurat ose datasheet me specifikimet teknike të produkteve të ofertuara. T'i bashkëngjitet deklarata se broshurat ose datasheet janë origjinale të prodhuesit.** **3. Të ofrohet një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, në të cilën deklarohet për realizimin e furnizimt për 60 ditë pas marrjes së urdhëresës.** **4.Të ofrohet një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, në të cilën deklarohet garancioni për pajisje për periudhën 2 vjeçare.** **5.Të ofrohet një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur nga OE për trajnimin e stafit për administrimin dhe operimin me pajise në sallën e trajnimeve të prodhuesit (trajnimi të organizohet për 3 persona)- shpenzimet OE** **6. Të ofrohet certifikata CE për pajisjet - kopje (me mundësi verfikimi).**

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Pjesë	Çmimi €	Vlera e parashikuar	Vërejtje &E-prokurimi
1.	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues:
Autoriteti Kontraktues për Ri-vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Ankesa është bere **kundër njoftimit për kontrate** para procesit të hapjes.

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni Ri-vlerësues ka konstatuar:

D E K L A R A T Ë:

- Ankesa është bere **kundër njoftimit për kontrate** para procesit të hapjes.

S.B

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: "Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. – Prishtinë.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur rregullat e LPP-së, konkretisht **neni 7, 28, 69 të LPP-së.**

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit) njësia e kërkesës duke hartuar kërkesa ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-se , duke kërkuar ne **Aneksin 1** (po citoj: **"Te jete prodhim evropian")** qe furnizimi/produktet te jenë te prodhuesit te njëjta dhe te prodhuara ne Evrope ne kundërshtim me **nenin 7 paragrafi 2, te LPP-se**, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik" **paragrafi 4, po citoj:** "*Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik*", **si dhe ne kundërshtim me paragrafin 5, po citoj:** *(ii) "që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik*". Gjithashtu, ne shkresën me **date 7 maj 2019**, Pergjigjie për Operatorin Ekonomik TETRONIKS LLC – Prishtine, Njësia e kërkesës, **z. Ali Caka,** jap një shpjegim në kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-së, po citoj: *"Kërkesa e njësisë kërkues te AK është për produkte cilësore nga prodhues Evropian, produktet e te cilëve janë te certifikuar për tregun evropian, dhe jo produkte te prodhuara nga vendet jashtë BE-se për përdorim ne BE"*, duke qenë në kundershtim me **nenin 28 paragrafin 2 dhe 7 te LPP-së**, po citoj: "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik", **paragrafi 7** "Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi".

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën/dëmshmin nga ZPP - AK te vendosur **nenin 9.1 & 9.2 pika 6) të FDT-së**, po citoj: "Kërkesa : **6.Të gjitha pajisjet e ofruara duhet të jenë të prodhuesit (brendit) të njëjtë dhe të prodhuara në Evropë. Dëshmia: 6. Të ofrohet certifikata CE për pajisjet - kopje (me mundësi verfikimi)".** Duke vepruar ne kundërshtim me **nenin 69 par. 1 dhe paragrafi 2.1 te LPP-se**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës"* ***paragrafi (2.1)*** *"listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesi"*. Gjithashtu duke marr për baze edhe shkresa me datë **6 maj 2019** drejtuar OE ankues nga **ZPP z/znj. Fortuna Nuka,** përgjigje ne kërkesën për informacione shtese te kërkuar nga OE ankues, po citoj: *"Specifikimet teknike nuk janë aspak favorizuese dhe te gjithë Operatoret Ekonomik qe kane kapacitete te mjaftueshme profesionale ua mundësojmë pjesëmarrjen e barabartë ne tenderim"* qe do thotë se nuk është arsyetuar dhe bazuar ne LPP, pasi ZPP – AK ne njoftimin për kontratë dhe dosje te tenderit konkretisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, përveç kërkesës " Autorizim nga Prodhuesi" asnjë kërkesë tjetër nuk mat kapacitet profesional, sepse autorizimin nga prodhuesi mund te marr edhe një firmë e ndërtimit (e cila nuk është e specializuar ne atë fushë), pasi AK ne njoftimin për kontratë dhe dosje te tenderit nuk ke kërkuar një liste me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet/shërbimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara (nga data e njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit), duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme sqarojë se **pretendimet e palës në këto pika të ankese janë të qëndrueshme.**

Gjithashtu, **Eksperti shqyrtues sqaron** se ky aktivitet i prokurimit, njoftimi për kontrate, rekomandoj AK-së, ta bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit, njoftimin për kontrate dhe specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1 në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së, të zgjat e afatit për dorëzimin e ofertave konformo nenit 53.7 të LPP-së, dhe **AK të respektoj në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së**.

S.B

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, në ankesa e OE: **"Tetroniks" Sh.p.k. L.L.C. – Prishtinë,** për tenderin e **AK: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Avancimi i sistemit të zërimit të ASHAK-ut",** me nr. prokurimi: **231-19-2534-1-2-1,** lidhur me njoftimin për kontratë, rekomandon që ankesa e OE ankues të **aprovohet e bazuar**, dhe autoriteti kontraktues të bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit dhe zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave konfirmo **nenit 53.7 të LPP-së**

S.B